



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA E SHKALLËS SË PARË E JURIDIKSIONIT TË PËRGJITHSHËM
TIRANË

Nr.Regj. 397

Dt. e Regjistrimit 05.02.2026

Nr. Vendimi 1416/3

Dt. Vendimi 04.03.2026

V E N D I M
“NË EMËR TË REPUBLIKËS”

Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, e përbërë prej:

NIKO RAPI - Gjyqtar i vetëm

sot në datë 04.03.2026, në Tiranë, unë, gjyqtari i Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, **Niko Rapi**, pasi mora në shqyrtim *në dhomë këshillimi* kërkesën/çështjen civile me nr.397 regj.them, e paraqitur nga:

KËRKUES: Qendra “FAKTOJE”, e regjistruar në Regjistrin e Organizatave Jofitimprurëse pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë me vendimin nr.1416, datë 30.07.2019 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, me NUIS L92111451K, me përfaqësues *Drejtoren Ekzekutive Klodiana Kapo*, shtetase shqiptare, e dtl.16.04.1981, me adresë njoftimi në Tiranë, rruga “Nasi Pavllo”, pallati “EDIT-AL”, shkalla 1, kati 3, apartamenti 8, në këtë gjykim e përfaqësuar nga Abdi Hatibi, sipas autorizimit të posaçëm datë 05.02.2026.

OBJEKTI: Kërkohet të bëhet depozitimi dhe regjistrimi në Regjistrin e Organizatave Jofitimprurëse pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, i vendimit të Bordit të Qendrës “FAKTOJE”, sipas aktit “Vërtetim nënshkrimi nr.956 rep, datë 02.02.2026, me objekt **ndryshimin e adresës** së subjektit, nga adresa e mëparshme rruga “Nasi Pavllo”, pallati “EDIT-AL”, shkalla 1, kati 3, apartamenti 8, në adresën e re: tek “Rruga e Barrikadave”, pallati ngitur me shkollën “Lidhja e Prizrenit”, shkalla 1, kati 9, apartamenti 91, në Tiranë-Shqipëri.

BAZA LIGJORE: Dispozitat e ligjit nr.8788, datë 07.05.2001 “Për Organizatat Jofitimprurëse”, i ndryshuar.
Dispozitat e ligjit nr.80, datë 24.06.2021, “Për Regjistrimin e Organizatave Jofitimprurëse”.
Dispozitat e Kodit Civil të RSH, për personat juridikë, nenet 24 e vijues, 41 të tij.

VËREN se:

I. Subjekti, Qendra “FAKTOJE”, është regjistruar si person juridik me vendimin nr. 1416/2, datë 30.07.2019 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë (sot Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë).

Ky subjekt (*qendër*) e ushtron veprimtarinë e saj (*në parim*) në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë, si një bashkim vullnetar dhe jopolitik, ndërsa në vendimin e regjistrimit theksohet edhe qëllimi i tij, organet drejtuese dhe anëtarësia (*e konfirmuar me vendimet gjyqësore përkatëse, sipas të dhënave të dosjes gjyqësore që është tërhequr prej këtij trupi gjykues nga Zyra e Regjistrimit të OJF-ve*).

- Kërkesa është regjistruar sikundër është thënë më lart dhe, sipas shortit elektronik të datës 09/02/2026 i ka kaluar për shqyrtim gjyqtarit Niko Rapi, i cili e ka marrë në dorëzim në datë 11/02/2026 (*kjo për efekt të marrjes në shqyrtim brenda afatit 15 ditë, sipas nenit 31 të ligjit nr.80/2021, si ligji i zbatueshëm në varësi të momentit të paraqitjes së kërkesës në gjykatë, e lidhur kjo edhe me momentin e marrjes së informacionit me shkrim nga Zyra e OJF-ve pranë kësaj Gjykate, shoqëruar kjo me procedurën e tërheqjes dhe vënies në dispozicion të trupit gjykues e dosjes gjyqësore të këtij subjekti*).

II. Sipas palës kërkuese, Bordi i Drejtorëve/Drejtues të subjektit Qendra “FAKTOJE”, ka njoftuar se në datën 19.01.2024, në selinë e subjektit do të kryhet mbledhja e Bordit Drejtues/të Drejtorëve (*shih njoftimin e anëtarëve nëpërmjet postës elektronike, me e-mail, njoftime të rregullta e të vlefshme, në përputhje me dispozitat e Statutit në fuqi, miratuar me vendimin gjyqësor të formës së prerë*).

Rezulton se në këtë datë/orë është realizuar mbledhja e Bordi Drejtues/i Drejtorëve të subjektit Qendra “FAKTOJE”, e shoqëruar me dokumentacionin (me procesverbalin) përkatës, e cila ka marrë vendime të tilla si:

- i. **Ndryshimin e adresës së subjektit:** Vendimit i Bordit të Qendrës “FAKTOJE”, sipas aktit “Vërtetim nënshkrimi nr.956 rep, datë 02.02.2026, me objekt ndryshimin e adresës së subjektit, nga adresa e mëparshme rruga “Nasi Pavllo”, pallati “EDIT-AL”, shkalla 1, kati 3, apartamenti 8, në adresën e re: tek “Rruga e Barrikadave”, pallati ngitur me shkollën “Lidhja e Prizrenit”, shkalla 1, kati 9, apartamenti 91, në Tiranë-Shqipëri.

Kështu, ka rezultuar se:

(a) në mbledhjen në fjalë, sipas aktit “Vërtetim nënshkrimi nr.956 rep, datë 02.02.2026” rezulton se vullnetin e kanë shprehur shtetasit Estela Koçi, Llazar Semini, Erjin Tase dhe Elisabeth Kathering Gowing, të gjithë nënshkrues të këtij akti.

Në këtë mbledhje dhe si miratues të kësaj vendimmarrjeje kanë marrë pjesë 4 (*katër*) nga 5 (*pesë*) anëtarë me të drejtë vote që/ janë dhe anëtarë të Bordit Drejtues/Bordit të Drejtorëve, të cilët janë po ata persona që e kanë këtë cilësi me vendimin e regjistrimit të këtij personi juridik dhe në vijim, konkretisht, sipas vendimit gjyqësor nr. 1416/2, datë 28.04.2023 dhe që e kanë ruajtur po këtë cilësi deri në vendimmarrjen e fundit për këtë person juridik (*lista e azhurnuar e anëtarëve e pasqyruar në dokumentacionin bashkangjitur kësaj kërkesë është korrekte sipas vendimt/eve gjyqësore në rrjedhë kronologjike për këtë subjekt si person juridik*);

(b) ana formale e dokumentacionit bashkangjitur kësaj kërkesë është në përputhje me dispozitat procedurale civile dhe me legjislacionin në fuqi duke u konfirmuar dhe vërtetuar

nënshkrimi i secilit person pjesëmarrës në këtë procedurë vendimmarrjeje dhe depozitimit (secili akt notërial i mbajtur pas verifikimit të identitetit të të gjithë nënshkruesve nëpërmjet dokumentit të identifikimit, bazuar në nenin 62, pika 1, gërma "ë", si dhe të nenit 128 të ligjit nr.1110/2018 "Për noterinë në RSH", si dhe të Udhëzimit të Ministrisë së Drejtësisë nr.6291, datë 17.08.2005, në lidhje edhe me ligjin nr.9887, datë 10.03.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale"), përshirë Procesverbalit i mbledhjes + Vendimi përkatës + Kërkesa për gjykim;

(c) vendimmarrja është në përputhje me Statutin e këtij personi juridik të organizuar në formën e **qendrës** si organizatë jofitimprurëse. Pra, nisur nga këto rregullime të brendshme të vetë organizatës jofitimprurëse, vendimmarrja është e vlefshme, kur merret **edhe me shumicën e thjeshtë**, si në rastin konkret (vendimet janë marrë nga ana e mbledhjes së Bordit Drejtues/Bordit të Drejtorëve të subjektit dhe jo nga ndonjë organ tjetër, nr.8788, datë 07.05.2001 "Për Organizatat Jofitimprurëse", i ndryshuar, si dhe me dispozitat e ligjit nr.80/2021 "Për Regjistrimin e Organizatave Jofitimprurëse", si dhe në përputhje me dispozitat e Statutit në fuqi, të përmendura pak më lart, i cili është miratuar me vendimin gjyqësor të formës së prerë);

(d) Kërkesa objekt gjykimi është depozituar brenda afatit të parashikuar nga ligji (neni 8 i ligjit nr.80/2021), pra, është depozituar brenda afatit 30 ditor nga momenti i ndodhjes së ngjarjes (dmth brenda 30 ditëve kalendarike nga data kur është mbajtur Mbledhja e Përgjithshme e anëtarëve, e cila është mbajtur në datën 02 shkurt 2026 dhe për të qenë brenda këtij afati duhet të ishte dërguar në gjykatë maksimalisht në datën 01 mars 2026, ndërsa rezulton që është dërguar jo me anë të shërbimit postar, por direkt në k/sekretari në datën 05 shkurt 2026 dhe është protokolluar në k/sekretari po në këtë datë). Ky veprim është në përputhje me nenin 8 të ligjit nr.80/2021 të përmendur më lart.

Kjo mbledhje ka ngarkuar Drejtorin Ekzekutiv të Qendrës, znj.Klodiana Kapo për ndjekjen e procedurave gjyqësore me qëllim regjistrimin e këtij vendimi (shih përmbajtjen e kërkesës dhe të vendimit objekt gjykimi).

III. Sipas kësaj Gjykate, duke analizuar përmbajtjen e plotë të kërkesës për gjykim të datës në lidhje me dokumentacionin që i është bashkangjitur kësaj kërkesë, si dhe duke e ballafaquar e duke e vlerësuar me të dhënat e dosjes gjyqësore për këtë person juridik, dosje e cila është tërhequr prej këtij trupi gjykues nga Zyra e Regjistrimit të OJF-ve pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë (vendimi paraardhës me nr.1416/2, datë 28.04.2023, vendim i dhënë nga trupi gjykues me gjyqtar E.Pollozhani, i cili është vendim pranimi dhe i formës së prerë, si vendim i paankimueshëm, pra, ky vendim ka marrë formë të prerë duke qenë se pala nuk ka patur të drejtë ankimi, meqënëse kërkesa është pranuar me vendimin në fjalë, sipas dispozitivit dhe sipas shënimit të k/sekretarisë, neni 451/a i K.Pr.Civile → shih dosjen e këtij subjekti të tërhequr prej sekretarisë për Regjistrimin e OJF-ve dhe vendimin e përmendur që është sjellë se bashku me këtë vërtetim), rezulton që kërkesa është në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe, si e tillë, duhet të pranohet.

Bashkëlidhur me kërkesën për depozitim, janë paraqitur nga pala kërkuuese **këto akte**:

- vendimi i Mbledhjes së Përgjithshme të anëtarëve të Bordit Drejtues/Bordit të Drejtorëve të Qendrës, si dhe procesverbalit përkatës;
- vërtetim nënshkrimi nga noteri;
- kopje e dokumenteve të identifikimit të anëtarëve të organit vendimmarrës;

I. Subjekti, Qendra “FAKTOJE”, është regjistruar si person juridik me vendimin nr. 1416/2, datë 30.07.2019 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë (sot Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë).

Ky subjekt (*qendër*) e ushtron veprimtarinë e saj (*në parim*) në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë, si një bashkim vullnetar dhe jopolitik, ndërsa në vendimin e regjistrimit theksohet edhe qëllimi i tij, organet drejtuese dhe anëtarësia (*e konfirmuar me vendimet gjyqësore përkatëse, sipas të dhënave të dosjes gjyqësore që është tërhequr prej këtij trupi gjykues nga Zyra e Regjistrimit të OJF-ve*).

Kërkesa është regjistruar sikundër është thënë më lart dhe, sipas shortit elektronik të datës 09/02/2026 i ka kaluar për shqyrtim gjyqtarit Niko Rapi, i cili e ka marrë në dorëzim në datë 11/02/2026 (*kjo për efekt të marrjes në shqyrtim brenda afatit 15 ditë, sipas nenit 31 të ligjit nr.80/2021, si ligji i zbatueshëm në varësi të momentit të paraqitjes së kërkesës në gjykatë, e lidhur kjo edhe me momentin e marrjes së informacionit me shkrim nga Zyra e OJF-ve pranë kësaj Gjykate, shoqëruar kjo me procedurën e tërheqjes dhe vënies në dispozicion të trupit gjykues e dosjes gjyqësore të këtij subjekti*).

II. Sipas palës kërkuese, Bordi i Drejtorëve/Drejtues të subjektit Qendra “FAKTOJE”, ka njoftuar se në datën **19.01.2024**, në selinë e subjektit do të kryhet mbledhja e Bordit Drejtues/të Drejtorëve (*shih njoftimin e anëtarëve nëpërmjet postës elektronike, me e-mail, njoftime të rregullta e të vlefshme, në përputhje me dispozitat e Statutit në fuqi, miratuar me vendimin gjyqësor të formës së prerë*).

Rezulton se në këtë datë/orë është realizuar mbledhja e Bordi Drejtues/i Drejtorëve të subjektit Qendra “FAKTOJE”, e shoqëruar me dokumentacionin (me procesverbalin) përkatës, e cila ka marrë vendime të tilla si:

- i. Ndryshimin e adresës së subjektit:** Vendimit i Bordit të Qendrës “FAKTOJE”, sipas aktit “Vërtetim nënshkrimi nr.956 rep, datë 02.02.2026, me objekt ndryshimin e adresës së subjektit, nga adresa e mëparshme rruga “Nasi Pavllo”, pallati “EDIT-AL”, shkalla 1, kati 3, apartamenti 8, në adresën e re: tek “Rruga e Barrikadave”, pallati ngitur me shkollën “Lidhja e Prizrenit”, shkalla 1, kati 9, apartamenti 91, në Tiranë-Shqipëri.

Kështu, ka rezultuar se:

(a) në mbledhjen në fjalë, sipas aktit “Vërtetim nënshkrimi nr.956 rep, datë 02.02.2026” rezulton se vullnetin e kanë shprehur shtetasit Estela Koçi, Llazar Semini, Erjin Tase dhe Elisabeth Kathering Gowing, të gjithë nënshkrues të këtij akti.

Në këtë mbledhje dhe si miratues të kësaj vendimmarrjeje kanë marrë pjesë 4 (*katër*) nga 5 (*pesë*) anëtarë me të drejtë vote që/ janë dhe anëtarë të Bordit Drejtues/Bordit të Drejtorëve, të cilët janë **po ata persona që e kanë këtë cilësi** me vendimin e regjistrimit të këtij personi juridik dhe në vijim, konkretisht, sipas vendimit gjyqësor nr.1416/2, datë 28.04.2023 dhe që e kanë ruajtur po këtë cilësi deri në vendimmarrjen e fundit për këtë person juridik (*lista e azhurnuar e anëtarëve e pasqyruar në dokumentacionin bashkangjitur kësaj kërkesë është korrekte sipas vendimt/eve gjyqësore në rrjedhë kronologjike për këtë subjekt si person juridik*);

(b) **ana formale e dokumentacionit** bashkangjitur kësaj kërkesë është në përputhje me dispozitat procedurale civile dhe me legjislacionin në fuqi duke u konfirmuar dhe vërtetuar